

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Kraioves në Rumani, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin e Kraioves, Rumani.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2024-2025 do të ndjekin studimet e tyre Master dhe Doktoraturë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT.

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2;
- Dokumenti Learning Agreement;

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Kraioves, Rumani lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë të vitit akademik 2024/2025 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana. Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti dhe mëpasnjë seksionin "sending university" firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

*****Për të marrë të gjitha dokumentet e nevojshme në lidhje me aplikimin tuaj, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë nëpërmjet e-mailit iro-projects@umt.edu.al**

Afati për aplikim: 5 Gusht, 2024

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!